



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:041794  
Datë: 04.12.2024  
Numri i dokumentit: 06549125

C-IV-13-3295

Parashtruesja e ankesës: S R nga Çagllavica e cila përfaqësohet nga V V avokat nga Prishtina.

Pala kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën;04.12.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga S R vërtetohet si i drejt dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PRN080-0506, i datës 18.10.2013, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 25.11.2013, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesë nga S R kundër palës kundërshtare Agjencia Kosovare e Privatizimit në lidhje me vendimin me numër PRN080-0506, të datës 18.10.2013, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e shumës prej 8,400.00€, në emër të kompensimit të pagave për periudhën kohore janar 1999- dhjetor 2005, nga NSH Industria e Tekstilit “Kosova Tex” (në likuidim).

Parashtruesja e ankesës në ankesën e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se në Ndërmarrjen Shoqërore Kosova Tex ka punuar deri në vitin 1999 kur nuk ishte e mundur që të vinte në punë, andaj edhe i është drejtuar Autoritetit të Likuidimit me kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore nga muaji janar 1999, deri në muajin dhjetor 2005. Autoriteti i Likuidimit me vendimin e kontestuar kërkesën për kompensim të pagave e ka refuzuar si të pa bazuar. Autoriteti i Likuidimit vendimin e vet e ka bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, me pretendimin se kërkesa kreditore është e parashkruar.

Me ankesën e parashtruar ka pretenduar se për shkak të përkatësisë etnike ka qenë e diskriminuar dhe përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ta anuloj vendimin me numër 11298, të datës 21.10.2013; t'i njihet e drejta e kompensimit të pagave për periudhën janar 1999- dhjetor 2005; të detyrohet pala kundërshtare që në emër të kompensimit të pagave për paggaura për periudhën kohore nga muaji janar 1999 deri në muajin dhjetor 2005, t'ia kompensoj shumën prej 8,400.00 €.

Ankesës si provë ia ka bashkangjitur:

- *Vendimin me numër PRN080-0506, të datës 18.10.2013, me të cilin kërkesa për kompensim të pagave i është refuzuar si e pa bazuar;*
- *Kopjen e librezës së punës;*
- *Vërtetimin e vitit 1999;dhe*
- *Vendimin e vitit 1998.*

Me datën 13.08.2014, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruar nga S R ku ndër të tjera ka theksuar se NSH Kosova Tex (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 15.01.2007. Parashtruesja e ankesës me datën 31.03.2007,ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 1999- dhjetor 2005, në shumën prej 8,400.00 €.

Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e saj në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN080-506, kërkesën e parashtruar nga e njëjta e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Me tutje ka theksuar se bazuar në nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034, ankuesja ka qenë e detyruar që të parashtroj ankesë në afatin prej 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Pala ankuese e ka pranuar vendimin me datën 22.10.2013 dhe ka qenë e detyruar që të parashtroj ankesë në gjykatë deri me datën 21.11.2013.

Në rastin konkret parashtruesja e ankesës ka dorëzuar ankesën me datën 25.11.2013, që të thotë se ankesa është dorëzuar jashtë afatit. Po ashtu ka theksuar se ankuesja me ankesë duhet të argumentoj se procedura e likuidimit nuk është bërë në përputhje me Ligjin me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Parashtruesja e ankesës poashtu nuk ka treguar me ankesë se cili nen i ligjit në fjalë është shkelur. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar nga S R ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Ligjit Nr.04/L-033.

### Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e ushtruar nga S R në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se parashtruesja e kërkesës ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga e njëjta në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN080-0506, kërkesën e parashtruar nga S R e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Parashtruesja e ankesës S R ka theksuar se ka punuar në ndërmarrje deri në vitin 1999, dhe se pas kësaj periudhe ka qenë e pa mundur që të paraqitet në punë. Në anën tjetër pala kundërshtarë e ka kontestuar pretendimin e saj të ushtruar në ankesë duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ngase parashtruesja e ankesës në lidhje me pagat e pa paguara të pretenduara nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent tri vite nga dita e arritjes së kërkesës nga viti 1999.

Në rastin konkret nga provat e shqyrtuara gjykata ka konstatuar se parashtruesja ankesës pretendon në paga të pa paguara që i referohen vitit 1999, dhe nuk ka prezantuar prova që dëshmon se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent në lidhje me borxhin e pretenduar deri në vitin 2003, që është koha e nevojshme për parashkrim të kërkesës së pretenduar. Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Rrjedhimisht në kuptim të dispozitës së lartë cekur gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e pretenduar e parashtrueses së ankesës S R për kompensim të pagave të papaguar është e parashkruar, andaj edhe gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenin 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### Këshilla Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi